



Në bazë të nenit 7, alineja 9 të Ligjit për themelim të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/07 dhe 5/09), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

THIRRJE PUBLIKE nr. 01/2012
për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga
Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2012

I. LËNDA E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpalljeje është ndarja e përkrahjes financiare për masat në vijim:

Masa 1	Rritja e konkurrencës së prodhimit bujqësor	
1.7	Investime në infrastrukturë për zhvillim të bujqësisë pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave	
	<i>Investime dedikuar për infrastrukturë për qasje deri tek toka bujqësore</i>	Vlera maksimale e harxhimeve të pranueshme për shfrytëzues deri më 1.000.000,00 denarë
	<i>Investime dedikuar për furnizim me energji elektrike dhe furnizim me ujë.</i>	Vlera maksimale e harxhimeve të pranueshme për shfrytëzues deri më 3.000.000,00 denarë për furnizim me energji elektrike.
Masa 3	Përmirësim i kualitetit të jetës në mjediset rurale dhe nxitje të diversifikimit të aktiviteteve ekonomike	
3.2	Përmirësim të kualitetit të jetës në mjediset rurale	
	Investime në infrastrukturën rrugore lokale (duke përfshirë edhe urat) për lidhjen e fshatrave deri në 2 km	Vlera maksimale e harxhimeve të pranueshme për shfrytëzues deri më 10.000.000,00 denarë, gjegjësisht deri më 17.000.000 denarë për investime të kombinuara – pika 1/2 dhe 3.
	Investime për ndërtim dhe/ose rikonstruim të rrugëve të fshatit (duke përfshirë edhe kanalizim atmosferik dhe elemente për këmbësorë) deri në 1 km	Vlera maksimale e harxhimeve të pranueshme për shfrytëzues deri më 10.000.000,00 denarë, gjegjësisht deri më 17.000.000 denarë për investime të kombinuara – pika 1/2 dhe 3
	Investime për ndërtim dhe/ose rikonstruim të shesheve, sipërfaqeve të gjelbra dhe/ose shëtitore në mjediset rurale deri më 30.000 banorë	Vlera maksimale e harxhimeve të pranueshme për shfrytëzues deri më 3.000.000,00 denarë, gjegjësisht deri më 17.000.000 denarë për investime të kombinuara – pika 1/2 dhe 3
	Shënim dhe rregullim të shtigjeve pyjore për çiklizëm	Vlera maksimale e harxhimeve të pranueshme për shfrytëzues deri më 3.000.000,00 denarë
	Rregullim të vendeve për piknik në mjediset rurale (duke përfshirë edhe lidhjen e tyre me energjinë elektrike, furnizim me ujë, kanalizim),	Vlera maksimale e harxhimeve të pranueshme për shfrytëzues deri më 3.000.000,00 denarë
	Shënimi i monumenteve kulturore dhe natyrore në mjediset rurale	Vlera maksimale e harxhimeve të pranueshme për shfrytëzues deri më 3.000.000,00 denarë
	Ndërtim dhe/ose rikonstruim të objekteve për qendra fëmijërore dhe për të rinj duke përfshirë edhe klubet e pensionistëve në fshat	



II. E DREJTA PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim, edhe atë për masat:

<i>Subjektet</i>	<i>Masa 1</i>
Njësitë e vetëqeverisjes lokale në territorin e të cilës gjendet mjedisi rural	Masa 1.7.1/2
Ekonomia bujqësore e evidentuar në NJZHEB	Masa 1.7.1
	<i>Masa 3</i>
Njësitë e vetëqeverisjes lokale në territorin e të cilës gjendet mjedisi rural	Masa 3.2

III. LARTËSIA E PËRKRAHJES FINANCIARE

Mjetet janë të dedikuara për investime për furnizim të mjeteve të reja themelore, harxhime operative në lidhje me mjetet e furnizuara dhe harxhime të tjera të parapara me Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2012.

Mbështetja financiare arrin 100% të vlerës të harxhimeve të pranueshme të lejuara për investim.

Përkrahja e ndarë financiare është e pakthyeshme.

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural mjetet i dërgon në kornizat e përcaktuara me Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2012.

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIM TË MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI QË DUHET TË DORËZOHET

Një kërkues mund të dërgojë **një** kërkesë për masën 1.7 – Investime në infrastrukturë për zhvillim të bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave për llojin e investimeve të dedikuara për infrastrukturë për qasje deri tek toka bujqësore, investime dedikuar për furnizim me energji elektrike dhe furnizim me ujë dhe **një** kërkesë për masën 3.2 – Investime për përmirësimin e kualitetit të jetës në mjediset rurale nga programi për një nga llojet në vijim të investimeve: shënimi i monumenteve kulturore dhe natyrore në mjediset rurale, shënim dhe rregullim të shtigjeve pyjore dhe për çiklizëm, rregullim të vendeve për piknik në mjediset rurale (duke përfshirë edhe lidhjen e tyre me energji elektrike, furnizim me ujë, kanalizim), gjegjësisht,

Një kërkues mund të dërgojë **një** kërkesë 3.2 – Investime për përmirësimin e kualitetit të jetës në mjediset rurale nga programi **për një ose më shumë** nga llojet në vijim të investimeve: investim në infrastrukturë rrugore (duke përfshirë edhe urat) për lidhje të fshatrave deri në 2 km, investime për ndërtim dhe/ose rikonstruim të rrugëve të fshatit (duke përfshirë edhe kanalizim atmosferik dhe elemente për këmbësorë) deri në 1 km, investime për ndërtim dhe/ose rikonstruim të shesheve, sipërfaqeve të gjelbra dhe/ose shëtitore në mjediset rurale deri më 30.000 banorë.

Njësitë e vetëqeverisjes lokale pas miratimit të investimeve nga ana e APFBZHR, janë të obliguar që të realizojnë procedurë tenderuese për të njëjtën në pajtim me Ligjin për furnizime publike.

Kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë kërkuesit e mjeteve janë të vërtetuara në Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2012, Rregullores për kritere të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve sipas masave për zhvillim rural dhe Rregullores për kushte të përafërta plotësuese për mbështetje nga masat për zhvillim rural, harxhimet e pranueshme dhe shuma e mbështetjes për harxhimet e pranueshme për shfrytëzues për masë të veçantë.

Kërkuesit të cilët i kanë plotësuar kushtet për shfrytëzim të mjeteve për masën 3.2 radhiten sipas pikëve të vërtetuara në Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve të masave për zhvillim rural.

V. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE

Formulari-Kërkesa për shfrytëzim të mjeteve së bashku me listën për dokumentet e duhura dhe Udhëzimit për shfrytëzuesit mund të merret në ueb faqen e Agjencisë www.ipardpa.gov.mk dhe drejtpërdrejtë në Agjenci në adresën:

**Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,
Bul. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20
(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C)
1000 Shkup**

VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuara për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2012 në gjuhën maqedonase së bashku me tërë dokumentacionin e duhur dorëzohen në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit "MOS HAP" për Thirrjen publike nr. 01/2012 dhe shënimin e numrit të



AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

masës/nën-sektor për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për humbjen apo hapjen e parakohshme të kërkesës.

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 01.10.2012. Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren në shqyrtim

Informata më të hollësishme në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresën: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në ueb-faqen: www.ipardpa.gov.mk.

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për aprovim të projekteve.

Telefoni **02 3097-460**, çdo ditë pune prej ora 10.00 deri në ora 16.00

E-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk